



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 27402 / Prot.  
2

Tiranë, më 31.12.2024

Lënda: Njoftimi në lidhje me zbatimin e Konventës Rajonale për rregullat preferenciale të origjinës pan-Euro-Mediterrane për vitin 2025.

**DEGËVE DOGANORE**  
**AGJENSIVE DOGANORE**  
**DEPARTAMENTEVE NË DPD**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Udhëzimin Nr. 5 datë 31.12.2024 "Dispozita Kalimtare në lidhje me zbatimin e Konventës Rajonale për rregullat e origjinës preferenciale pan-Euro-Mediterrane 1 janar 2025 deri më 31 dhjetor 2025".

Të merren masat e menjëhershme për njohjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Duke Ju falenderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

**Çenti Gazheli**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

№ 27407/ Prot.  
↑

Tiranë, më 3.12.2024

UDHËZIM

№ 5. Datë 31.12.2024.

“Dispozita Kalimtare në lidhje me zbatimin e Konventës Rajonale për rregullat e origjinës preferenciale pan-Euro-Mediterrane nga janar 2025 deri më 31 dhjetor 2025”.

DEGËVE DOGANORE

AGJENSIVE DOGANORE

DEPARTAMENTEVE NË DPD

Ky dokument udhëzues është i një natyre shpjeguese dhe ilustruese. Legjislacioni doganor i Shqipërisë si dhe legjislacioni doganor i vendeve të tjera që janë palë kontraktuese në Konventë ka përparësi mbi përmbajtjen e këtij dokumenti.

Ky dokument udhëzues është bazuar në Udhëzimin e Komisionit Evropian të përgatitur nga grupi i ekspertëve të Doganave – Seksioni i Origjinës (CEG-ORI).

AKRONIMET DHE PËRKUFIZIMET

**HS:** Sistemi i Harmonizuar i Përshkrimit dhe Kodimit të Mallrave (HS), i referuar zakonisht si Sistemi i Harmonizuar, është një sistem ndërkombëtar për klasifikimin e mallrave i zhvilluar nga Organizata Botërore e Doganave (OBD).

**Konventa:** Konventa Rajonale mbi rregullat preferenciale të origjinës pan-Euro-Mediterrane (Konventa)

**PK:** Palët Kontraktuese të Konventës me të cilat vendi ynë zbaton një Marrëveshje të tregtisë së Lirë.

- BE,
- Shtetet e EFTA-s (Zvicra, Norvegjia, Islanda dhe Lihtenshtejni),
- Pjesëmarrësit në Procesin e Stabilizim Asociimit të BE-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Maqedonisë së Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova,
- Republika e Moldavisë

**Komiteti i Përbashkët:** Komiteti i Përbashkët i krijuar nga Konventa.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autostada Tiranë-Durrës, Km 1, Rr. Industriale, Paltoni Center, Kati 5,  
Tiranë [www.dogana.gov.al](http://www.dogana.gov.al)

**Rregullat e 2012:** Rregullat në Shtojcën I të Konventës botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së OJ L54 të 26 shkurtit 2013 dhe në Fletoren Zyrtare të Shqipërisë FZ 7 datë 20 shkurt 2012 (Ligji Nr. 1/2012, datë 26.01.2012).

**Rregullat e 2023:** Rregullat në Shtojcën I të Konventës në versionin e saj të ndryshuar me Vendimin Nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët, Ligji ynë 59/2024 datë 6 qershor i publikuar në FZ nr. 113 datë 4 korrik 2024) dhe publikuar në FZ të BE-së OJ L 2024/390 të datës 19 shkurt 2024.

Protokollet e vjetra PEM: Protokollet dypalëshe të zbatueshme ndërmjet Palëve Kontraktuese që përmbajnë rregullat e origjinës që i paraprijnë Konventës të botuar në EU OJ L54 të 26 shkurtit 2013.

**Rregullat Tranzitore të origjinës:** grup rregullash origjinë të zbatueshme në baza dypalëshe midis disa Palëve Kontraktuese, paralelisht me rregullat e vitit 2012, në pritje të miratimit dhe hyrjes në fuqi të rregullave të vitit 2023 me BE-në (Vendimet: Nr. 1/2021, i Këshillit të Stabilizim-Asociimit BE-AL, Ligji Nr. 98/2021, datë 07.07.2021; i Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore CEFTA, Ligji Nr. 101/2021, datë 07.07.2021; i Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë EFTA, Ligji Nr. 99/2021 datë 07.07.2021.

### **Vështrim i Përgjithshëm**

Konventa është e zbatueshme nëpërmjet një reference për ta përfshirë atë në protokollet mbi rregullat e origjinës në Marrëveshjet përkatëse dypalëshe ndërmjet palëve kontraktuese.

Mundësitë e kumulimit në zonën e PEM bazohen në një rrjet marrëveshjesh ndërmjet PK që parashikojnë zbatimin e kumulimit dhe kanë rregulla identike të origjinës. Këtu përfshihen rregullat e Konventës së vitit 2012 si dhe protokollet dypalëshe të vjetra PEM, të cilat konsiderohen identike.

Paralelisht, një grup alternativ i rregullave të origjinës (rregullat tranzitore të origjinës) janë zbatuar krahas rregullave të vitit 2012. Këto rregulla hynë në fuqi që nga 1 shtatori 2021 në një bazë dypalëshe midis disa PK-ve, në pritje të hyrjes në fuqi të rregullave të vitit 2023. Shqipëria i ka zbatuar rregullat tranzitore me BE-në, Vendet EFTA dhe vendet CEFTA. Zbatimi i rregullave kalimtare të origjinës paralelisht me rregullat e vitit 2012 krijoi dy zona të veçanta kumulimi.

Konventa u amendua me Vendimin Nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët të 7 dhjetorit 2023<sup>1</sup>, duke zëvendësuar rregullat e vitit 2012 me rregullat e vitit 2023. Ky amendament hyn në fuqi më 1 janar 2025 në lidhje me të gjitha PK.

Zbatimi efektiv ndërmjet PK i rregullave të vitit 2023 kushtëzohet me futjen e një reference ndaj Konventës siç është përfshirë në marrëveshjet dypalëshe (lidhje dinamike) në MSA me BE-në, marrëveshjen CEFTA dhe marrëveshjen EFTA-AL. Në pritje të përditësimit të marrëveshjeve dypalëshe midis disa PK-ve me referencë në Konventë, rregullat e zbatueshme të origjinës ndërmjet atyre PK do të jenë rregullat që përmbahen në protokollet e tyre dypalëshe (rregullat e vitit 2012 ose protokollet e vjetra PEM).

<sup>1</sup> Vendimi 1/2023 i KP të Konventës Rajonale pan-Euro-Mesdhetare të Origjinës i datës 7 dhjetor 2023 për amendimin e Konventës Rajonale pan-Euro-Mesdhetare të Origjinës [2024/390] dhe Ligji ynë 59/2024

Që nga 1 janari 2025, disa PK do të zbatojnë rregullat e 2023 ndërsa të tjerat do të zbatojnë ende rregullat e 2012, me ndryshime të mundshme në mundësitë e kumulimit diagonal që ndikojnë në flukset tregtare të vendit tonë në zonën e PEM.

Meqenëse kalimi drejt rregullave të vitit 2023 nuk është i njëkohshëm për të gjitha PK, duhet të shmangët sa më shumë që të jetë e mundur që kjo të çojë në një situatë më pak të favorshme se kuadri ligjor i mëparshëm. Prandaj, dispozitat kalimtare në lidhje me zbatimin e Konventës vendosen për një periudhë njëvjeçare, nga 1 janari 2025 deri më 31 dhjetor 2025.

Qëllimi kryesor i dispozitave kalimtare është ruajtja e rregullave të vitit 2012 të zbatueshme paralelisht me rregullat e vitit 2023 ndërmjet PK-ve për të cilat rregullat e vitit 2023 hyjnë në fuqi. Kjo do të sigurojë ruajtjen e flukseve tregtare bazuar në mundësitë e kumulimit që ekzistojnë përpara datës 1 janar 2025. Operatorët ekonomikë kanë mundësinë të zgjedhin midis dy grupeve të rregullave të zbatueshme, bazuar në zinxhirët e tyre të furnizimit.

Dispozitat kalimtare sigurojnë gjithashtu parimin e përshkueshmërisë ndërmjet dy grupeve të rregullave të origjinës. Kjo do të thotë që mallrat e konsideruara si origjinuese në kuptimin e rregullave të vitit 2012 mund të konsiderohen gjithashtu si origjinuese në kuptimin e rregullave të vitit 2023 për qëllime kumulimi, me kusht që të plotësohen disa kushte.

Ky kontekst i ri ruan fleksibilitetet për operatorët ekonomikë si në praktikën e vendosur nga zbatimi paralelisht me rregullat tranzitore të origjinës me rregullat e vitit 2012 që nga 1 shtatori 2021.

Meqenëse procesi i miratimit të rregullave të Vendimit të vitit 2023 si dhe dispozitave kalimtare të vitit 2024 nuk do të jenë në të njëjtën kohë, kjo do të çojë në tre statuse të ndryshme ndërmjet PK gjatë vitit 2025. Duhet të theksohet se një PK mund të jetë nën disa statuse të ndryshme në varësi të përmbajtjes së protokollit dypalësh me partnerët e tij të ndryshëm PEM.

## **1. Statusi i PK**

**Statusi CR: Palët Kontraktuese që zbatojnë rregullat e vitit 2023 dhe dispozitat kalimtare ndërmjet njëra-tjetrës.**

Ky status u jep eksportuesve mundësinë të zgjedhin midis rregullave të vitit 2012 dhe rregullave të vitit 2023, duke përfituar nga mundësitë e kumulimit sipas çdo grupi rregullash. Ai gjithashtu lejon përshkueshmërinë midis dy grupeve të rregullave.

**Statusi R: Palët Kontraktuese që zbatojnë rregullat e 2023 ndërmjet njëra-tjetrës pa dispozitat kalimtare.**

Ky status përfaqëson ato PK që kanë përditësuar protokollin e tyre dypalësh me një lidhje dinamike me Konventën, por nuk kanë përfunduar ende procedurat e brendshme në lidhje me miratimin e dispozitave kalimtare.

Sipas këtij statusi zbatohen rregullat e vitit 2023 dhe kumulimi diagonal do të jetë i mundur bazuar vetëm në rregullat e vitit 2023. Mundësitë e kumulimit sipas rregullave të vitit 2023 pritet të zgjerohen gjatë gjithë vitit 2025.

**Statusi C: Palët Kontraktuese që zbatojnë rregullat e vitit 2012 ose protokollet e vjetra PEM ndërmjet njëra-tjetrës.**

Ky status përfaqëson ato PK që ende zbatojnë rregullat e 2012 ose protokollet e vjetra PEM sipas protokolleve të tyre ekzistuese dypalëshe të cilat ende nuk janë përditësuar me një lidhje dinamike. Kumulimi diagonal do të jetë i mundur bazuar vetëm në rregullat e vitit 2012.

## **2. Dispozitat kalimtare të paraqitura me Vendimin Nr. 2/2024.**

Dispozitat kalimtare do të zbatohen për PK-të që po zbatojnë rregullat e vitit 2023 dhe kanë ratifikuar Vendimin Nr. 2/2024 të Komitetit të Përbashkët. Këto dispozita do të minimizojnë ndërprerjen e kumulimit ndërmjet PK dhe ata që nuk kanë përafruar ende protokollet e tyre dypalëshe do të përfitojnë në mënyrë indirekte duke u mbajtur në flukset tregtare.

Neni 42 (1)

*Shtojca 1 e Konventës e botuar në OJ L54/4 e datës 26.02.2013 do të zbatohet ndërmjet Palëve Kontraktuese të Konventës deri më 31 dhjetor 2025 paralelisht me këtë shtojcë.*

Paragrafi i parë siguron që rregullat e 2012-ës të vazhdojnë të zbatohen për një vit shtesë paralelisht me rregullat e 2023-ës, të cilat do të hyjnë në fuqi më 1 janar 2025.

Kjo dispozitë nënkupton që dy grupe rregullash, të cilat do të krijojnë dy zona të veçanta kumulimi, do të zbatohen nga 1 janari 2025 deri më 31 dhjetor 2025.

### Shembull

*Pala A dhe Pala B po zbatojnë ndërmjet njëra-tjetrës të dy grupet e rregullave - statusin CR  
Pala D po zbaton vetëm rregullat e vitit 2023 me A dhe B – statusin R  
Pala E po zbaton vetëm rregullat e vitit 2012 me A dhe B – statusin C*

*Kumulimi diagonal është i mundur midis A, B dhe D bazuar në rregullat e 2023  
Kumulimi diagonal është i mundur midis A, B dhe E bazuar në rregullat e 2012*

Neni 42 (2)

*Dëshmitë e origjinës të lëshuara ose të bëra përpara datës 1 janar 2025 në përputhje me rregullat për zbatim opsional të Konventës në pritje të përfundimit dhe hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Konventës (rregullat tranzitore të origjinës) dhe të dorëzuara pas kësaj date, brenda periudhës së tyre të vlefshmërisë, do të pranohet për trajtim preferencial në import për mallrat të cilat, më 1 janar 2025, janë ose në tranzit ose të vendosura nën një procedure të veçantë nën kontroll doganor. Këto mallra mund të përdoren për kumulim siç parashikohet në nenin 7.*

Kjo dispozitë siguron që mallrat në tranzit ose magazinim, me një provë të vlefshme të origjinës të lëshuar ose të bërë në përputhje me rregullat tranzitore të origjinës, nuk do të humbasin statusin e origjinës dhe trajtimin preferencial kur të kenë arritur në destinacionin e tyre, pas 1 janarit 2025.

Ai siguron që provat e origjinës të lëshuara ose të bëra në vitin 2024 në kuadrin e rregullave tranzitore të origjinës të pranohen për trajtim preferencial në vitin 2025, brenda periudhës së vlefshmërisë së tyre. Afati i vlefshmërisë së këtyre provave të origjinës është dhjetë muaj nga data e lëshimit.

Mallrat e mbuluara nga provat e origjinës të lëshuara ose të bëra në përputhje me rregullat tranzitore të origjinës në vitin 2024 mund të përdoren për qëllime të kumulimit sipas rregullave të 2023.

*Shembuj të provave të origjinës të lëshuara ose të bëra sipas rregullave kalimtare të origjinës:*

**English version**

The exporter of the products covered by this document (customs authorization No.....<sup>1)</sup> declares that, except where otherwise clearly indicated, these products are of .....<sup>2</sup> preferential origin according to the transitional Rules of origin.

1. Exporter (Name, full address, country)	T.U.R.I. No A 000.000 <small>to apply on exit before completing this form</small>	
3. Consignee (Name, full address, country) (Optional)	2. Certificate used in preferential trade between ..... and ..... <small>(Name, short name, country, group of countries or territories)</small>	
	4. Country, group of countries or territory in which the products are considered as originating	5. Country, group of countries or territory of destination
6. Transport details (Optional)	7. Remarks  <b>TRANSITIONAL RULES</b>	
8. Item number; Mark and number; Number and kind of packages <sup>1)</sup> ; Description of goods	9. Gross mass (kg) or other measure (litre, m <sup>3</sup> , etc.)	10. Invoice <sup>2)</sup> (Optional)
11. CUSTOMS ENDORSMENT <small>Declaration on export Export document No. .... Of ..... Customs office Invoice number of 14271027 Place and date</small>	Stamp	12. DECLARATION BY THE EXPORTER <small>If the undersigned declares that the goods described above meet the conditions required for the issue of this certificate</small>  Place and date  Signature
<sup>1)</sup> If goods are not packed, indicate number of articles or state the weight, as appropriate. <sup>2)</sup> Complete and include the registration of the exporting manufacturer, if applicable.		

*Shembull:*

*Pala A dhe Pala B po zbatojnë ndërmjet njëra-tjetrës rregullat tranzitore të origjinës përpara 1 janarit 2025 dhe rregullat e vitit 2023 pas 1 janarit 2025.*

*Pala A dhe Pala B po zbatojnë me palën D rregullat e 2023 pas 1 janarit 2025.*

*Pala B po zbaton me Palën D Vendimin 2/2024.*

*Pala A mund të jetë në statusin R ose CR, por Pala B dhe Pala D duhet të jenë në statusin CR që të mund të zbatojnë dispozitat kalimtare.*

*Pala A eksporton në Palën B më 23 dhjetor 2024 mallra të mbuluara nga një provë të origjinës e lëshuar ose e bërë në përputhje me rregullat tranzitore të origjinës. Mallrat janë importuar në Palën B më 5 janar 2025. Trajtimi preferencial jepet në momentin e importimit. Më tej, Pala B mund t'i përdorë ato mallra në një skemë kumulimi sipas rregullave të 2023 me Palën D.*

#### Neni 42 (3)

*Në rastet e paraqitjes me vonesë të provave të origjinës të lëshuara ose të bëra përpara datës 1 janar 2025 në përputhje me rregullat tranzitore të origjinës, neni 23, paragrafët (2) dhe (3) do të zbatohen për mallrat e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni.*

Kjo dispozitë siguron që në rast paraqitjeje të vonuar, provat e origjinës të lëshuara ose të bëra në përputhje me rregullat tranzitore të origjinës nuk do të refuzohen nëse plotësohen kushtet e nenit 23, si p.sh.

- Mosdorëzimi i këtyre provave brenda afatit është për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme; Ose
- Produktet e mbuluara nga prova e origjinës janë paraqitur në administratën doganore të palës importuese përpara skadimit të provës së origjinës.

Rrethanat e jashtëzakonshme në këtë kontekst i referohen rasteve të rralla që janë jashtë kontrollit të importuesit ose përfaqësuesit të tyre dhe nuk rrezikojnë mundësinë e autoriteteve doganore për të verifikuar origjinën e mallrave (të tilla si katastrofa natyrore ose raste të tjera të forcës madhore).

#### Neni 42 (4)

*Provat e origjinës të lëshuara ose të bëra në përputhje me Shtojcën I të Konventës, botuar në FZ OJ L54/4, datë 26.02.2013 të KE (FZ e Shqipërisë FZ 7 datë 20 shkurt 2012) ose të lëshuara në përputhje me rregullat e origjinës të Protokollit që i paraprin Konventës përpara datës së hyrjes në fuqi të amendamentit të protokolleve dypalëshe ndërmjet Palëve Kontraktuese për të përfshirë referencën ndaj Konventës që është ndryshuar së fundi dhe është paraqitur pas kësaj date, të pranohen brenda periudhës së vlefshmërisë së tyre për trajtim preferencial në import për mallrat të cilat, në atë datë, janë ose në tranzit ose të vendosura nën një procedurë të veçantë nën kontrollin doganor. Në rast të paraqitjes me vonesë të këtyre provave, zbatohet neni 23, paragrafët (2) dhe (3).*

Kjo dispozitë siguron që mallrat në tranzit ose magazinim, me një provë të vlefshme të origjinës të lëshuar ose bërë sipas rregullave të vitit 2012 ose protokolleve të vjetra PEM, nuk do të humbasin statusin e origjinës dhe trajtimin preferencial kur të kenë arritur në destinacionin e tyre pas datës së hyrjes në fuqi të lidhjes dinamike me Konventën.

Ai siguron që provat e origjinës të lëshuara ose të bëra në përputhje me rregullat e vitit 2012, ose Protokolleve të vjetra PEM, pranohen për trajtim preferencial pas datës së hyrjes në fuqi të lidhjes dinamike, brenda periudhës së vlefshmërisë së tyre. Afati i vlefshmërisë së këtyre vërtetimeve të origjinës është katër muaj nga data e lëshimit.

### Shembull

*Pala A dhe Pala B janë ende duke zbatuar pas 1 janarit 2025 protokollin e vjetër PEM - statusin C.*

*Protokolli dypalësh midis A dhe B që përmban lidhjen dinamike hyn në fuqi më 1 mars 2025 duke i bërë të zbatueshme midis A dhe B rregullat e 2023 nga ajo datë.*

*Pala A po lëshon një provë origjine në përputhje me protokollin e vjetër PEM më 15 shkurt 2025.*

Mallrat e mbuluara nga kjo dëshmi e origjinës importohen në Palën B më 10 maj 2025. Në momentin e importit do të jepet trajtim tarifor preferencial.

Në rast të paraqitjes me vonesë, zbatohen kushtet e nenit 23, i cili përcakton se dëshmia e origjinës nuk refuzohet nëse:

- Mosdorëzimi i këtyre dokumenteve deri në datën përfundimtare është për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme;  
Ose
- Produktet e mbuluara nga prova e origjinës janë paraqitur në administratën doganore të palës importuese përpara skadimit të provës së origjinës.

Rrethanat e jashtëzakonshme në këtë kontekst i referohen rasteve të rralla që janë jashtë kontrollit të importuesit ose përfaqësuesit të tyre dhe nuk rrezikojnë aftësinë e autoriteteve doganore për të verifikuar origjinën e mallrave (të tilla si katastrofa natyrore ose raste të tjera të forcës madhore).

### Neni 42 (5)

*Provat e origjinës të lëshuara ose të bëra përpara datës 1 janar 2026 në përputhje me paragrafin 1 ose në përputhje me rregullat e origjinës të përfshira në Protokollin që i paraprijnë Konventës dhe të dorëzuara pas kësaj date brenda periudhës së vlefshmërisë së tyre, do të pranohen për trajtim preferencial gjatë importimit për mallrat të cilat, më 1 janar 2026, janë ose në tranzit ose janë vendosur nën një procedurë të veçantë nën kontroll doganor. Në rast të paraqitjes me vonesë të këtyre provave, zbatohet neni 23, paragrafët (2) dhe (3).*



Kjo dispozitë siguron që mallrat në tranzit ose magazinim, me një provë të vlefshme të origjinës të lëshuar ose të bërë sipas rregullave të vitit 2012 ose protokolleve të vjetra PEM gjatë vitit 2025, nuk do të humbasin statusin origjinues dhe trajtimin preferencial kur të mbërrijnë në destinacionin e tyre pas 1 janarit 2026.

Ai siguron që provat e origjinës të lëshuara ose të bëra në përputhje me rregullat e vitit 2012, ose të Protokollit të vjetra PEM, pranohen për trajtim preferencial pas datës 1 janar 2026, brenda periudhës së vlefshmërisë së tyre. Afati i vlefshmërisë së këtyre provave të origjinës është katër muaj nga data e lëshimit.

*Shembull:*

*Pala A dhe Pala B janë ende duke zbatuar pas 1 janarit 2025 protokollin e vjetër PEM - statusi C.  
Ose*

*Pala A dhe Pala B po zbatojnë rregullat e 2012 dhe rregullat e 2023 në 2025 - statusi CR.*

*Pala A më 15 dhjetor 2025 po lëshon një provë origjine në përputhje me rregullat e vjetra PEM, protokollin e 2012.*

*Mallrat e mbuluara nga kjo provë origjine importohen në Palën B më 10 shkurt 2026. Në kohën e importit jepet trajtimi preferencial.*

Në rast të paraqitjes me vonesë, zbatohen kushtet e nenit 23, i cili përcakton se prova e origjinës nuk refuzohet nëse:

- Mosdorëzimi i këtyre provave deri në datën përfundimtare është për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme;

*Ose*

- Produktet e mbuluara nga prova e origjinës janë paraqitur në administratën doganore të palës importuese përpara skadimit të dokumentit të origjinës.

Rrethanat e jashtëzakonshme në këtë kontekst i referohen rasteve të rralla që janë jashtë kontrollit të importuesit ose përfaqësuesit të tyre dhe nuk rrezikojnë mundësinë e autoriteteve doganore për të verifikuar origjinën e mallrave (të tilla si katastrofa natyrore ose raste të tjera të forcës madhore).

Neni 42 (6)

*Për qëllime verifikimi, neni 33 paragrafi 2, nenet 34 dhe aty ku është e zbatueshme, neni 35 do të zbatohen gjithashtu për provat e origjinës të lëshuara ose të bëra në përputhje me rregullat kalimtare të origjinës dhe provat e origjinës të lëshuara ose të bëra sipas protokolleve që i paraprinë Konventës së zbatueshme përpara datës 1 janar 2025.*

Kjo dispozitë zgjeron kuadrin e bashkëpunimit administrativ të rregullave të vitit 2023 në lidhje me verifikimin për ti zbatuar edhe në 2025 në lidhje me verifikimin e origjinës në kuadër të rregullave tranzitore të origjinës dhe të protokolleve të vjetra PEM.

Neni 42 (7)

*Për qëllime verifikimi, neni 33 paragrafi 2 dhe neni 34 do të zbatohen gjithashtu nëse kërkesa për verifikim është paraqitur pas datës 1 janar 2026 ose pas datës së hyrjes në fuqi të ndryshimit të*

*protokolleve dypalëshe ndërmjet Palëve Kontraktuese për të përfshirë referencën për Konventën e ndryshuar së fundi, për provat e origjinës të lëshuara ose të bëra në përputhje me Shtojcën I të Konventës, botuar në OJ L54/4 të 26.02.2013 (FZ 7 datë 20 shkurt 2012) dhe Protokolleve që i paraprijnë Konventës.*

Kjo dispozitë zgjeron kuadrin e bashkëpunimit administrativ të rregullave të vitit 2023 në lidhje me kërkesat për verifikim, për t'u zbatuar edhe në vitin 2026 në lidhje me ato provave të origjinës të lëshuara ose të bëra në kuadrin e rregullave të vitit 2012 dhe të protokolleve të vjetra PEM.

#### Neni 42 (8)

*Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën, çdo katër muaj, nëpërmjet Komisionit Evropian, për gjendjen e përditësimit të protokolleve të tyre dypalëshe për të përfshirë referencën ndaj Konventës të ndryshuar së fundi dhe masat e marra për të siguruar që rregullat e rishikuara të Konventës zbatohen efektivisht më 1 janar 2026.*

Kjo dispozitë inkurajon të gjitha PK të finalizojnë procedurat e brendshme në mënyrë që vetëm rregullat e vitit 2023 të jenë të zbatueshme për të gjitha PK-të nga 1 janari 2026. Përveç kësaj, ajo siguron që mundësitë e kumulimit në Njoftimin e Komisionit (Matriksi) të përditësohen gjatë gjithë vitit 2025.

#### Neni 42 (9)

*Certifikatat e qarkullimit të mallrave EUR. I të lëshuara në përputhje me këtë Shtojcë do të përfshijnë deklaratën në anglisht 'REVISED RULES' në kutinë 7. Kjo deklaratë do të shtohet gjithashtu në fund të tekstit të deklaratës së origjinës të bërë në përputhje me këtë Shtojcë. Deklarata do të përfshihet në dëshmitë e origjinës deri më 31 dhjetor 2025.*

Për të bërë dallimin midis dy grupeve të rregullave, provat e origjinës të lëshuara ose të bëra sipas rregullave të vitit 2023 duhet të përfshijnë deklaratën "REVISED RULES", deri më 31 dhjetor 2025. Që nga 1 janari 2026, rregullat e 2012 nuk do të jenë më të zbatueshme paralel me rregullat e vitit 2023. Prandaj, që nga ajo datë kjo deklaratë nuk do të jetë më e nevojshme. Megjithatë, provat e origjinës duke përfshirë këtë deklaratë pas 1 janarit 2026 nuk duhet të refuzohen.

Dëshmitë e origjinës të lëshuara ose të bëra në vitin 2025, që përfshijnë gabimisht deklaratën "TRANSITIONAL RULES" në vend të "REVISED RULES" nuk duhet të refuzohen.

#### **Shënim:**

Deklarata "REVISED RULES" duhet të përfshihet vetëm në provat e origjinës të lëshuara ose të bëra për mallrat e eksportuara në një PK me të cilën zbatohet Vendimi 2/2024 (statusi CR) dhe jo për mallrat e eksportuara në një PK me të cilën zbatohen vetëm rregullat e 2023 (statusi R).

Megjithatë, dëshmitë e origjinës duke përfshirë gabimisht deklaratën "REVISED RULES" nuk duhet të refuzohen gjatë importimit në një KP që nuk zbatohet në atë kohë Vendimi 2/2024.

### English version

The exporter of the products covered by this document (customs authorization No.....<sup>1</sup>) declares that, except where otherwise clearly indicated, these products are of .....<sup>2</sup> preferential origin according to the **Revised Rules of origin**.

1. Exporter (Name, full address, country)		EUR.1 No A 000.000	
See notes overleaf before completing this form			
3. Consignee (Name, full address, country) (Optional)		2. Certificate used in preferential trade between ..... and ..... (Insert appropriate countries, groups of countries or territories)	
		4. Country, group of countries or territory in which the products are considered as originating	5. Country, group of countries or territory of destination
6. Transport details (Optional)		7. Remarks  <b>REVISED RULES</b>	
8. Item number; Marks and numbers; Number and kind of packages <sup>11</sup> ; Description of goods		9. Gross mass (kg) or other measure (litres, m <sup>3</sup> , etc.)	10. Invoices (Optional)
<b>11. CUSTOMS ENDORSEMENT</b> <i>Declaration certified</i> Export document <sup>12</sup> Form: ..... No ..... Of: ..... Customs office ..... Issuing country or territory ..... ..... Place and date ..... ..... (Signature) .....		<b>12. DECLARATION BY THE EXPORTER</b> I, the undersigned, declare that the goods described above meet the conditions required for the issue of this certificate. ..... Place and date ..... ..... (Signature) .....	
If goods are not packed, indicate number of articles or state in bulk, as appropriate. Complete only where the regulations of the exporting country or territory require.			

### Neni 8, (1a)

*Kumulimi i parashikuar në nenin 7 mund të zbatohet për mallrat e klasifikuara sipas kapitujve 1, 3, 16 (për produktet e peshkimit të përpunuar) dhe 25 deri në 97 të Sistemit të Harmonizuar që kanë marrë statusin e origjinës bazuar në zbatimin e rregullave të origjinës të përfshira në nenin 42*

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autostada Tiranë-Durrës, Km 1, Rr. Industriale, Pajtoni Center, Kati 5, Tiranë [www.dogana.gov.al](http://www.dogana.gov.al)

*paragrafi 1 dhe dispozitat përkatëse të Shtojcës II si dhe nga zbatimi i rregullave të origjinës të përfshira në Protokollet në lidhje me përcaktimin e konceptit të 'produktet origjinuese' dhe metodat e bashkëpunimit administrativ që i paraprijnë Konventës me kusht që materialet dhe produktet janë me origjinë nga Palët Kontraktuese për të cilat kumulimi është i mundur, siç paraqitet në "Njoftimin e Komisionit në lidhje me zbatimin e Konventës Rajonale për rregullat preferenciale të origjinës pan-Euro-Mediterrane ose protokolleve mbi rregullat e origjinës që sigurojnë kumulimin diagonal ndërmjet PK të Konventës Rajonale, sipas publikimit të fundit në FZ të BE-së.*

*Ky paragraf do të zbatohet për periudhën e parashikuar në nenin 31 paragrafi 1 për mallrat e mbuluara nga dëshmitë e origjinës të përmendura në nenin 42 paragrafi 4 dhe 5.*

Kjo dispozitë lejon përshkueshmërinë midis rregullave të 2012 dhe rregullave të 2023 (vetëm nga rregullat e 2012 tek rregullat e 2023) kur bëhet fjalë për kumulimin. Kjo do të thotë se dispozitat e kumulimit të rregullave të 2023 mund të zbatohen edhe për produktet sipas rregullave të 2012 në ato raste kur produktet plotësojnë kërkesat e të dy grupeve të rregullave.

Meqenëse rregullat e origjinës të 2012 janë në përgjithësi më kufizuese se rregullat e 2023, me disa përjashtime, mallrat që plotësojnë rregullat e 2012 mund të kualifikohen sipas rregullave të 2023.

Përshkueshmëria do të thotë që origjina e produktit përfundimtar mund të merret sipas rregullave të vitit 2023 me zbatimin e kumulimit me materialet me origjinë sipas rregullave të 2012, ku kumulimi është i mundur sipas matricës.

Përshkueshmëria është e kufizuar në ato produkte për të cilat rregullat e 2023 janë më të relaksuara se ato të rregullave të 2012:

- Produktet e kapitujve 1, 3 dhe 16 për produktet e peshkimit të përpunuara të sistemit të harmonizuar.

Ose

- Produktet industriale të klasifikuara sipas kapitujve 25 deri 97 të Sistemit të Harmonizuar.

Nëse këto produkte janë origjinuese sipas rregullave të vitit 2012, ato mund të konsiderohen origjinuese edhe sipas rregullave të 2023.

### **3. Matriksi i kumulimit**

Bazuar në statutet e përmendura në pikën 2, në Njoftimin e Komisionit që tregon mundësitë e kumulimit sipas protokolleve të vjetra PEM, rregullat e 2012 dhe rregullat e 2023, R përfaqëson mundësitë e kumulimit sipas rregullave të 2023 dhe C përfaqëson mundësitë e kumulimit sipas rregullave të 2012 së bashku me Protokollet e vjetra PEM.

PK që zbatojnë Vendimin Nr. 2/2024 në lidhje me dispozitat kalimtare, janë në gjendje të zbatojnë si rregullat e vitit 2012 ashtu edhe rregullat e vitit 2023 me PK të tjera bazuar në marrëveshjet e tyre dypalëshe.

Prandaj, në kutitë përkatëse të matricës, tregohet CR, që përfaqëson mundësitë për të kumuluar sipas të dy grupeve të rregullave.

Simulimi i tabelës së Njoftimit të Komisionit:

	BE	AL	MK	TR
BE		R	CR	C <sup>1</sup>
AL	R		R	C <sup>1</sup>
MK	CR	R		C <sup>1</sup>
TR	C <sup>1</sup>	C <sup>1</sup>	C <sup>1</sup>	

**Ky shembull nuk pasqyron mundësitë reale të kumulimit në asnjë datë. Kjo listë është në përditësim të vijshëm.**

*Shembuj se si të lexoni tabelën I të skemës së kumulimit (Matriksi):*

BE-ja dhe MK po zbatojnë të dy grupet e rregullave ndërmjet tyre - statusi CR – pasi po zbatojnë dispozitat kalimtare të Vendimit 2/2024.

BE po zbaton me AL vetëm rregullat e vitit 2023 - statusin – R – pasi Shqipëria nuk zbaton ende dispozitat kalimtare të Vendimit 2/2024.

Turqia mund të zbatojë vetëm rregullat e vitit 2012 me AL - statusi C

Turqia mund të zbatojë rregullat e vitit 2012 me BE dhe MK, meqenëse e ka miratuar Vendimin 2/2024 - statusi C.

AL dhe BE me TR mund të kumulojnë sipas rregullave të 2012 - statusi C.

BE dhe MK me TR mund të kumulojnë sipas rregullave të 2012 - statusi C.

BE-ja, AL dhe MK mund të kumulojnë vetëm sipas rregullave të vitit 2023 – statusi R, pasi AL nuk po zbaton ende dispozitat kalimtare të Vendimit 2/2024.

MK dhe BE mund të kumulojnë me materiale me origjinë nga AL sipas rregullave të 2023 duke zbatuar Vendimin 2/2024.


*Shembuj praktik me përshkueshmëri:*

Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe BE dhe mund të përdorin mallra me origjinë nga Turqia (të klasifikuara sipas kapitujve 1, 3, 16 për produktet e përpunuara të peshkimit si dhe 25 deri në 97 të Sistemit të Harmonizuar) dhe të kumuloohen në përputhje me rregullat e 2023 duke zbatuar përshkueshmërinë<sup>2</sup>.

BE-ja dhe MK, të cilat të dyja kanë status CR, mund të kumulojnë me materiale me origjinë nga Shqipëria, sipas rregullave të vitit 2023 dhe bazuar në përshkueshmërinë. Edhe pse MK dhe Turqia kanë vetëm statusin C, kumulimi sipas rregullave të 2023 mund të bëhet kur materialet me origjinë nga Turqia sipas rregullave të 2012 përdoren në prodhimin e mallrave me origjinë nga MK sipas rregullave të 2023 për eksportet në BE, koncepti i përshkueshmërisë zbatohet ndërmjet MK dhe BE-së në përputhje me dispozitën kalimtare të Vendimit 2/2024. Megjithatë, nëse produktet eksportohen nga BE-ja përsëri në MK, atëherë nga MK ato nuk mund të eksportohen më ose të kumuloohen në Shqipëri sipas rregullave të 2012, të cilat janë rregullat e vetme të zbatueshme midis MK dhe Shqipërisë.

<sup>2</sup> Kumulimi zbatohet vetëm për produktet që mbulohen nga Bashkimi Doganor BE\_TR. Nuk zbatohet kumulimi për produktet agrare si dhe të qymyrit dhe hekurit

BE-ja mund të importojë materiale me origjinë nga Turqia sipas rregullave të vitit 2012, statusi C. Materialet hyrëse mund të përdoren për qëllime kumulimi në BE sipas rregullave të 2023 bazuar në përshkueshmërinë, dhe më tej të eksportohen dhe kumulohen në MK. Megjithatë, kumulimi i mëtejshëm nuk është i mundur me Shqipërinë, sepse Vendimi 2/2024 nuk është i zbatueshëm ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë. Produktet nuk mund të eksportohen më tej ose të kumulohen në Turqi sipas rregullave të 2012, që është i vetmi grup rregullash të zbatueshme midis Turqisë dhe të tjerave.



#### 4. Përmbledhje në lidhje me dëshmitë e origjinës:

Lista e provave të origjinës të cilat, kur lëshohen ose bëhen sipas kuadrit ligjor në fuqi të vitit 2024, do të pranohen në vitin 2025 brenda periudhës së vlefshmërisë së tyre, si dhe në rastet e paraqitjes së vonuar:

- Certifikatat EUR.1 të lëshuara dhe deklaratat e origjinës të bëra sipas rregullave të vitit 2012 ose Protokolleve të vjetra PEM (të pranuar në statusin CR dhe C)
- Certifikatat EUR-MED të lëshuara dhe deklaratat e origjinës EUR-MED të bëra sipas 2012 rregullat ose protokolleve të vjetra PEM (të pranuar në statusin CR dhe C)
- Certifikatat EUR.1 të lëshuara dhe deklaratat e origjinës të bëra në kuadrin e rregullave kalimtare të origjinës (të pranuar në statusin CR dhe R)

Lista e provave të origjinës të cilat, kur lëshohen ose bëhen sipas kuadrit ligjor në fuqi të vitit 2025, do të pranohen në vitin 2025 dhe 2026 brenda periudhës së vlefshmërisë së tyre, si dhe në rastet e paraqitjes me vonesë:

- Certifikatat EUR.1 të lëshuara dhe deklaratat e origjinës të bëra sipas rregullave të vitit 2012 ose të protokolleve të vjetra PEM (të pranuar në statusin CR dhe C)
- Certifikatat EUR-MED të lëshuara dhe deklaratat e origjinës EUR-MED të bëra sipas rregullave të vitit 2012 ose të protokolleve të vjetra PEM (të pranuar në statusin CR dhe C)
- Certifikatat EUR.1 të lëshuara dhe deklaratat e origjinës të bëra sipas rregullave të vitit 2023 duke përfshirë deklaratën "REVISED RULES" (pranuar në statusin CR dhe R)

Lista e provave të origjinës që mund të lëshohen sipas kuadrit ligjor në fuqi nga 1 janar 2026 e në vazhdim:

- Certifikatat EUR.1 të lëshuara dhe deklaratat e origjinës të bëra në kuadrin e rregullave të vitit 2023, të cilat nuk duhet të përfshijnë më deklaratën "REVISED RULES"

Gjatë plotësimit të DAV, kur në praktikën doganore në lidhje me mallrat origjinuese ka një provë origjine preferenciale më deklaratën "REVISED RULES", tek kutia 44 e dokumentave bashkangjitur, duhet të vendoset:

- kodi R 862 – Certifikata EUR.1, ose
- kodi R 863 – Deklaratë-Faturë
- në vijim shënohet numri dhe data që i korrespondon dokumentit

## 5. Shënimet shpjeguese

Shënimet shpjeguese në lidhje me protokollet pan-Euro-Mediterrane mbi rregullat e origjinës, vazhdojnë të zbatohen për dispozitat përkatëse të Konventës<sup>3</sup>.

*Ngarkohen Degët doganore dhe Agjensitë doganore për zbatimin e këtij udhëzimi.*

**DREJTORI PËRGJITHSHËM**

**Gent Gazheli**



<sup>3</sup> Official Journal of the European Union C83/1 date 17.04.2007